



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

KONKURSI PËR FESTIVALIN E KËNGËS QYTETARE “ZAMBAKU I PRIZRENIT 2024”

“Zambaku i Prizrenit 2024” hap konkursin për këngët pjesëmarrëse në edicionin 35-të festivalit. Organizatorët e festivalit ftojnë të gjithë krijuesit dhe interpretuesit e këngës së vjetër qytetare, nga të gjitha trevat shqiptare në konkurrim për pjesëmarrje në këtë edicion.

KUSHTET E KONKURIMIT

Këngët konkurse duhet të jenë në frymën e këngës Qytetare
Kënga duhet të jetë origjinale dhe nuk duhet të jetë e publikuar më parë (në të kundërtën eliminohet edhe pas selektimit)
Krijuesit duhet dorëzuar partituren e cila përbanë vijen melodike, tekstin dhe shifrimin harmonik (në USB apo CD mund të bashkangjitet edhe demo verzioni i kënduar
Teksti i melodies duhet të printohet në tërësi (e gjitha strofat)
Krijuesit prezantohen në festival me vetëm një këngë.
Konkursi për pranimin e këngëve është i hapur nga 23.04.2024 deri më 15.05.2024.

SHPERBLIMET E FESTIVALIT:

Vendi i parë 1000 €
Vendi i dytë 700 €
Vendi i tretë 500 €
Çmimi i publikut “Zambaku i Prizrenit” (për autorin e këngës) 1000 €
Çmimi “Mikrofoni i Artë” (për interpretuesin e këngës) 500 €
Çmimi për tesktin më të mirë “Pena e artë” 100 €

DOKUMENTACIONI I KOMPLETUAR:

Dorzohet me një zarf në adresën: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Prizrenit
Me zarf të hapur me shifër, kurse me zarf të mbyllur jepën të dhënat për autorin e muzikës dhe të tekstit.

Me respekt



Drejtori i DKRS-së
Adem Morina